



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738*

*E-mail: [rmuca@klsb.org.al](mailto:rmuca@klsb.org.al); Web-site: [www.klsb.org.al](http://www.klsb.org.al)*

Nr. 98/14 Prot.

Tiranë, më 28/09/2017

**V E N D I M**  
**Nr. 130, Datë 28/09/2017**

**PËR**  
**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**  
**“RUAJTJA E EKOSISTEMIT TË PARKUT KOMBËTAR TË PRESPËS”**

Në zbatim të planit vjetor 2017, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI etj.), sipas programit të auditimit Nr. 98/4, datë 10.04.2017, realizoi auditimin me temë “Ruajtja e Ekosistemit të Parkut Kombëtar të Prespës”. Ky auditim u programua për t’u ushtruar në Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Bashkinë e Pustecit dhe Bashkinë e Devollit, për periudhën e aktivitetit 2012 – 2016. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr. prot. 98/4, datë 30.06.2017 iu dërgua projekt-raporti i auditimit institucioneve subjekt auditimi. Raporti i auditimit është hartuar pasi janë shqyrtuar dhe u morën parasysh shpjegimet e dërguara nga institucionet e përfshira në këtë auditim të cilat janë trajtuar në mënyrë të hollësishme në Raportin e Auditimit.

Nëpërmjet këtij auditimi, është analizuar performanca e detyrimeve të aktorëve të cilat kanë përgjegjësi në menaxhimin e Parkut Kombëtar të Prespës, për të dhënë rekomandimet e duhura për përmirësimin e gjendjes aktuale të Parkut të Prespës dhe ruajtjen e kësaj pasurie natyrore. Përmirësimi dhe reduktimi i problematikave social-mjedisore të shfaqura gjatë këtij auditimi do të minimizonte gjithashtu presionin e komunitetit mbi pasuritë natyrore të Parkut e të Prespës. Gjatë këtij auditimi grupi i auditimit ka shqyrtuar të gjithë dinamikën e ndërhyrjeve dhe presionit urban mbi Parkun e Prespës, veprimtarinë e institucioneve shtetërore për kontrollin dhe reduktimin e këtyre ndërhyrjeve si dhe gjetjen e zgjidhjeve afat-gjata e të qëndrueshme.

Pas përfundimit të projekt-raportit, subjekti i audituar AKZM me shkresën nr. prot. 764/1 datë 31.07.2017, përgjithësisht konfirmon gjetjet e grupit të auditimit, me sqarime të pjeshme, të cilat në disa raste prekin konkluzionet e arritura dhe mbi të cilat grupi i auditimit ka dhënë shpjegimet e nevojshme për çdo pikë të kundërshtuar nga AKZM. Bashkia e Pustecit me shkresën nr. prot 209 datë 30.06.2017, ka paraqitur observacion mbi projekt – raportin, me disa komente dhe sqarime për çështje të veçanta, duke u dakordësuar me përfundimet e arritura. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave si dhe Bashkia e Devollit nuk kanë paraqitur observacione.

Në përfundim, pasi u njoha me raportin përfundimtar të auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit, të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, shkronja “c” të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”:

### **K O N K L U D O V A:**

Parku Kombëtar i Prespës është shpallur me VKM Nr. 80 datë 18.2.1999. Sipas përcaktimit të Ligjit Nr. 9868, datë 4.2.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” Parku Kombëtar i Prespës klasifikohet si “Kategoria II” e zonave të mbrojtura. Plan i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Prespës është miratuar me Urdhër të Ministrisë të Mjedisit Nr. 1792 datë 09.05.2014. Qëllimi kryesor i Planit të Menaxhimit është mbrojtja e ekosistemeve dhe funksionimi i tyre për të ofruar shërbimet e tyre për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme të njerëzimit. Ky Plan Menaxhimi bazohet në deklaratat respektive të vizionit dhe të misionit, të cilat do të shërbejnë si udhëzues për Parkun Kombëtar dhe menaxherët e tij për të siguruar në të ardhmen një performancë më të mirë. Në këtë plan menaxhimi përshkruhen kërcënimet me të cilat ballafaqohet ky park si edhe zgjidhjet e mundshme kundrejt këtyre kërcënimeve.

Administratat e zonave të mbrojtura janë të ekspozuara ndaj interesave divergjente dhe presioneve të forta që kanë të bëjnë me ekosistemet për të cilat ato duhet të kujdesen. Kështu, ato duhet jo vetëm të mësojnë se si të mirëmbajnë vlerat e biodiversitetit, por gjithashtu si të komunikojnë me vendimmarrësit e tjerë, komunitetin e zonës dhe sektorë të tjerë publikë me qëllim garantimin e mbijetesës afatgjatë të ekosistemeve në përgjegjësi të tyre. Detyrat kryesore të politikëbërësve, vendimmarrësve, është mbrojtja e natyrës dhe burimeve natyrore për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Vlerat e biodiversitetit të Parkut Kombëtar janë ende të kërcënuara nga përkeqësimi i rëndë i ekosistemeve tokësore nga mbikullotja, prerja e pyjeve për dru zjarri dhe nga gjuetia ilegale. Kjo është shoqëruar gjithmonë me një keqadministrim të pasurive ujore e peshkore duke ndotur ujërat liqenore, duke mos trajtuar ujërat e ndotur urbane, duke futur lloje të huaja peshqish dhe duke peshkuar me metoda jo të përshtatshme e jo tradicionale.

Në lidhje me pyetjen kryesore të këtij auditimi,

*“A ka qenë efektive ruajtja e ekosistemit të Parkut Kombëtar të Prespës?”*, u arrit në këtë mesazh:

Gjendja aktuale e Parkut Kombëtar të Prespës është fryt i presionit të vazhdueshëm në dekadat e fundit nga banorët si dhe nga menaxhimi jo i mirë i institucioneve përgjegjëse. Shfrytëzimi pa kriter i pyjeve, prerja e pakontrolluar e druve të zjarrit për ngrohje dhe në disa raste edhe për tregtim të jashtëligjshëm, gjuetia dhe peshkimi i paligjshëm, mosmenaxhimi i mbetjeve urbane dhe ujërave të zeza si dhe mos bashkëpunimi i institucioneve të cilët kanë për detyrë të menaxhojnë dhe të bashkërendojnë veprimet e tyre për të ruajtur të gjithë ekosistemin në Parkun e Prespës janë problemet kryesore të evidentuara në këtë auditim. Megjithatë, disa nga faktorët kërcënues të përkeqësimit të ekosistemeve janë reduktuar dhe pyjet kanë mundësinë për t’u rimëkëmbur nëse do të merren parasysh dhe nëse do të zbatohen me përpikmëri rekomandimet e lëna nga ky auditim. Institucionet e përfshira në menaxhimin e PKP nuk kanë zbatuar të gjitha objektivat e Planit të Menaxhimit duke filluar që me menaxhimin e druve

të zjarrit, menaxhimin e peshkimit, gjuetisë së paligjshme etj. AdZM Korçë nuk ka zbatuar plotësisht objektivat e Planit të Menaxhimit të PKP sa i përket menaxhimit të pyjeve. Nuk është shpallur zona e bashkëmenaxhimit në liqenet e Prespës e për rrjedhojë të gjithë peshkatarët nga viti 2013 e deri më sot kanë funksionuar si të jashtëligjshëm. Performanca e Bashkisë Pustec dhe Devoll lidhur me menaxhimin e mbetjeve është cënuar në të tre parimet e saj (ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet). Bashkia Pustec dhe Bashkia Devoll për disa vite me rradhë nuk kryejnë menaxhimin e mbetjeve në përputhje me ligjin nr. 10463 të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane, duke i hedhur dhe duke i djegur ose duke i lënë të vetëdijshëm në mjedise të hapura. E njëjta gjë ndodh edhe me shkarkimin e ujërave të zeza në liqenet e Prespës dhe filtrimin e tyre në ujërat nëntokësore të cilat më pas ndotin tokat bujqësore e përfundojnë në basenin ujëmbledhës të liqeneve të Prespës. Shfrytëzimi i burimeve ujore nëpërmjet puseve të ujit është totalisht jashtë çdo lloj monitorimi dhe kontrolli nga Drejtoria e Politikave të Burimeve Ujore dhe nga Inspektoriat Shtetëror i Ujit. Ato nuk kanë asnjë të dhënë për sasinë e ujit të shfrytëzuar nga banorët apo bizneset vendase, numrin dhe vendndodhjen e saktë të këtyre puseve.

Nisur nga konkluzionet e mësipërme të veprimtarisë audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të rezultateve:

## V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të Performancës “Ruajtja e Ekosistemit të Parkut Kombëtar të Prespës”, të ushtruar në institucionet publike përgjegjëse për menaxhimin e Parkut të Prespës.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

**I.** Për pyetjen: **A ka qenë efektive performanca e aktorëve të menaxhimit të PKP lidhur me prerjen e pakontrolluar të druve të zjarrit?**

**Gjetje:**

- Grupi i auditimit gjatë vizitave në terren ka evidentuar grupe dhe individë të ndryshëm, banorë të fshatrave brenda Parkut të Prespës, por edhe të fshatit Tren apo fshatrave të tjera, të cilët janë gjetur duke transportuar dru të sapoprerë. Të gjithë këta banorë janë pyetur nëse janë kontrolluar nga administrata e parkut duke u përcaktuar vendin apo nëse ua kanë regjistruar sasinë e prerë të druve dhe kohën në të cilën janë prerë. Të gjitha përgjigjet e tyre kanë dëshmuar qartë se mbi ata nuk është ushtruar asnjë lloj kontrolli. Për të dëshmuar sa më mirë këto evidenca janë realizuar disa foto si dhe janë marrë informacione me anë të pyetësorëve. Fakti që në dy ditë të ndryshme (03.03.2017 dhe 22.05.2017) të vizitave të grupit të auditimit në terren janë parë shumë raste në shumë pak orë tregon që menaxhimi aktual i druve të zjarrit ka nevojë për përmirësim ose për shtim të kapaciteteve humane në administratën e parkut. Duke marrë parasysh përgjigjet e pyetësorëve drejtuar banorëve të parkut në lidhje me kontrollin që administrata kryen gjatë prerjeve të druve të zjarrit 46% e të anketuarëve thotë se nuk kryhet asnjë kontroll, 40% janë përgjigjur se kryhet kontroll në nivel mesatar dhe 14% janë shprehur se kontrolli është shumë i lartë. Sa i përket pyetjes nëse banorët kanë informacione për prerje të paligjshme dhe tregtim të druve të zjarrit 44% e të anketuarëve janë përgjigjur se nuk kanë asnjë informacion të tillë, 44% janë përgjigjur se kanë informacione të mjaftueshme për një gjë të tillë dhe 12% janë shprehur se kanë shumë dijeni për ngjarje të tilla.

- AdZM Korçë ka në stafin e saj 27 punonjës, nga të cilët vetëm 6 janë të sektorit të menaxhimit dhe monitorimit për Parkun e Prespës (duke mos përfshirë drejtuesit).
- Popullata lokale zakonisht djeg dru zjarri të porsaprera, kur lagështia është rreth 60%.

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

- Grupi i auditimit, duke dashur të japë një zgjidhje sa më të qëndrueshme dhe duke marrë parasysh edhe situatën e rënduar social-ekonomike të banorëve të parkut, rekomandon që për një zonë pilot: aktivitetet e shfrytëzimit/prerjes së druve të zjarrit të kontraktohen nga shoqata apo kompani private, të licencuara për punime pyjore dhe për t'i shërbyer kërkesave të popullsisë lokale. Kjo e bën më të lehtë kontrollin nga ana e administratës së parkut. Vetëm anëtarët e këtyre shoqatave apo kompanive do të lejohen për të prerë dru dhe do të kenë veshje të veçantë që të dallohen menjëherë. Çdo anëtar i tyre do të ketë një mjet identifikimi nga ana e parkut në mënyrë që të kontrollohet për aktivitetin e menaxhimit nga administrata e parkut. AKZM të lidhë kontratën me shoqatën/kompaninë. Nëse kjo rezulton e suksesshme të shtrihet në territorin e të gjithë parkut.

***Brenda muajit Maj 2017***

- AKZM, në bashkëpunim me MM, të propozojë pranë Këshillit të Ministrave shtimin e numrit të punonjësve (deri në 16) të sektorit të Parkut të Prespës të AdZM Qarku Korçë.

***Brenda muajit Shkurt 2017***

- Administrata e parkut të gjejë mekanizma të përshtatshme për “të detyruar” banorët vendas për konsumin e druve të zjarrit për ngrohje me lagështi maksimale 20-25 % dhe jo më shumë me qëllim rritjen e fuqisë kalorifike të tyre.

***Brenda vitit kalendarik 2018***

#### **Për pyetjen: A ka qenë efektive performanca e aktorëve të menaxhimit të PKP lidhur me gjuetinë e pakontrolluar?**

##### **Gjetje:**

- Gjuetia e paligjshme kryhet në shumicën e rasteve natën. Gjuetarët janë të pajisur me armë gjahu. ISHMP Korçë nuk ka evidentuar qoftë një rast të vetëm të kryerjes së gjuetisë së paligjshme. Kështu, nuk ka asnjë masë penalizuese të ndërmarrë kundrejt kundravajtësve të cilët kryejnë gjueti të paligjshme.
- Inspektorët e ISHMP nuk janë të pajisur me armë zjarri.
- Mosmbajtja e armëve nga ana e ISHMP Korçë është kërkuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit Korçë nëpërmjet një shkrese me Nr. prot. 1879 datë 31.03.2016.
- ISHMP Korçë nuk ka një plan të mirëdetajuar vjetor/mujor ku të jenë të përcaktuar detyrat specifike për mbrojtjen e faunës.
- Sipas pyetësorëve, 33% janë shprehur se nuk kanë asnjë informacion mbi zhvillimin e gjuetisë në Parkun e Prespës, 56% janë shprehur se kanë mjaftueshëm informacione dhe 11 % kanë shumë informacione mbi zhvillimin e gjuetisë, e cila është totalisht e ndaluar në Parkun Kombëtar të Prespës.

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

- Inspektorët e ISHMP dhe “rangers-at” e AdZM Korçë që monitorojnë gjuetinë e paligjshme, duke patur të njëjtin rol si policia pyjore në të kaluarën, duhet të pajisen me

armë. Për këtë qëllim, AdZM dhe ISHMP t'i bëjnë kërkesë zyrtare MM, e cila, nga ana e vet, të kërkojë ndryshimin e kuadrit ligjor.

***Brenda muajit Mars 2018***

- Të rritet numri i kontrolleve në bazë të një plani vjetor e mujor të mirëpërcaktuar.

***Brenda muajit Shkurt 2018 e në vazhdimësi***

- ISHMP të mbajë procesverbale për çdo kontroll të kryer në terren, si dhe në raste të gjuetisë së paligjshme të merren masa sipas ligjit nr. 10253 datë 11.03.2010 "Për gjuetinë".

***Në vazhdimësi***

**Për pyetjen: A ka qenë efektive performanca e aktorëve të menaxhimit të PKP lidhur me peshkimin e pakontrolluar?**

**Gjetje:**

- Liqenet e Prespës nuk janë shpallur zona të bashkëmenaxhimit të peshkimit.
- Nuk është miratuar Planin i Bashkëmenaxhimit për Liqenet e Prespës.
- Aktualisht nuk ka asnjë peshkatar të licensuar si pasojë e mosrinovimit të Kontratës midis OMP-së dhe MBZHRAU qysh prej 2013.
- DSHPA ka marrë vetëm dy masa dënimi me gjobë për dy shtetas me vlerë nga 100.000 Lekë secili, pasi kanë përdorur rrjetë peshkimi në kundërshtim me aktet n/ligjore dhe asnjë masë ndëshkimi ndaj peshkatarëve të cilët ushtrojnë e peshkojnë pa leje peshkimi. Dy njësitë kryesore të hartimit të politikave dhe zbatimit të tyre (DPP dhe DSHPA) nuk kanë dijeni që në të dy Liqenet e Prespës ka zona të veçanta në të cilat ndalohet aktiviteti i peshkimit sic theksohet në Planin e Menaxhimit të PKP. Nga kjo mund të kuptohet rrjedhimisht që të dy këto Drejtori nuk kanë dijeni apo njohuri mbi Planin e Menaxhimit të PKP.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

- Drejtoria e Politikave të Peshkimit në MBZHRAU të ndjekë në KM miratimin final të zonës bashkëmenaxhuese të Liqeneve të Prespës.

***Brenda vitit 2017***

- Pas shpalljes së Liqeneve të Prespës si Zonë Bashkëmenaxhimi, të miratohet Planin i Bashkëmenaxhimit nga DPP dhe OMP për një periudhë 10-vjeçare.

***Brenda 12 muajve nga shpallja e Liqeneve të Prespës si Zonë Bashkëmenaxhimi***

- DPP dhe DSHPA të njihen me Planin e Menaxhimit të PKP, objektivat dhe detyrimet që ai përcakton lidhur me peshkimin.

***Menjëherë***

- Planet e punës së Drejtorisë së Politikave të Peshkimit dhe Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës të hartohen në përputhje me Planin e Menaxhimit të PKP.

***Brenda muajit Shkurt 2018***

- DSHPA të ushtrojë kontrolle të vazhdueshme në zonat e ndaluara për peshkim.

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

Për pyetjen: **A ka qenë efektive performanca e aktorëve të menaxhimit të PKP lidhur me menaxhimin e mbetjeve urbane?**

**Gjetje:**

- Bashkia e Pustecit nuk ka të miratuar Planin Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve, i cili hartohet në përputhje me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve, bazuar në Ligjin Nr. 10463 datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
- Bashkia Pustec nuk ka asnjë Rregullore ku të përcaktohet kontrolli për menaxhimin e rrymave specifike të mbetjeve që gjenerohen në territorin e vet përfshirë letrën, kartonin, ambalazhet prej qelqi, metali e plastike të pijeve dhe ushqimeve, mbetjet organike etj.
- Në Parkun Kombëtar të Prespës ekzistojnë disa venddepozitime të paligjshme të mbetjeve. Në këto venddepozitime mbetjet digjen në mjedis të hapur, duke u bërë shkak për dëmtimin e cilësisë së ajrit, cilësisë së tokës si dhe ujërave sipërfaqësore e nëntokësore. Ministria e Mjedisit, nëpërmjet ISHMP-së, ka gjobitur dy herë Bashkinë e Pustecit për hedhjen dhe djegien e mbetjeve urbane në mjedis të hapur.
- Në të gjithë parkun nuk vërehet asnjë kosh për grumbullimin e mbetjeve.
- Në Bashkinë e Pustecit nuk ka asnjë punonjës të specializuar në çështjet e mjedisit.
- Aktualisht Bashkia Pustec ka dy dampa (venddepozitime të pakontrolluara të mbetjeve urbane) të hapura me një sipërfaqe totale rreth 5000 m<sup>2</sup>.
- Fshati Tren, i cili është në administrimin e Bashkisë së Devollit, shkarkon të gjitha mbetjet urbane në hyrje të Parkut Kombëtar të Prespës vetëm 100 m nga shpella e Trenit. Kjo jo vetëm ndikon në cilësinë e ujërave të Liqenit të Prespës së Vogël dhe cilësinë e tokave e ajrit, por ka dhe një ndikim negativ sa i përket pamjes estetike duke qenë se të gjithë turistët ballafaqohen me këtë gjendje në hyrje të parkut.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

- Bashkia e Pustecit të miratojë Planin Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane në përputhje me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve.

***Menjëherë***

- Bashkia e Pustecit të mbyllë të dyja dampat ekzistuese të depozitimit të mbetjeve.

***Menjëherë***

- Bashkia e Pustecit të ushtrojë kontrole të rrepta ndaj hedhjes dhe depozitimeve të paligjshme të mbetjeve urbane, të cilat në shumë raste digjen ose vetëdigjen.

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

- Bashkia e Pustecit të zbatojë Variantin II (mbi skemën e menaxhimit të mbetjeve urbane) të propozuar nga grupi i auditimit në Raportin e Auditimit, si zbatim të standardeve dhe të ligjit mbi menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane dhe, në të njëjtën kohë, të rentabilitetit ekonomik që ky variant garanton.

***Me miratimin e buxhetit të ardhshëm***

- Bashkia Pustec të dërgojë dhe të depozitojë të gjitha mbetjet (përveç mbetjeve organike) në Landfillin e Maliqit.

***Me miratimin e buxhetit të ardhshëm***

- Bashkia Pustec të vendosë 10 konteinerë (kosha) me kapacitet 700 kg për grumbullimin e mbetjeve, duke shpërndarë 1 konteiner për çdo 500 banorë.

***Me miratimin e buxhetit të ardhshëm***

- Bashkia e Pustecit të ndërgjegjësojë banorët vendas për depozitimin e mbetjeve organike në kopshtet e tyre vetjake me anë të takimeve, lajmërimeve apo formave të tjera të komunikimit.

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

- Bashkia e Devollit të pastrojë vendgrumbullimet e paligjshme të mbetjeve urbane në hyrje të Parkut të Prespës në afërsi të fshatit Tren.

***Menjëherë***

- Bashkia e Pustecit dhe Devollit të organizojnë takime ndërgjegjësuese dhe sensibilizuese me banorët e parkut, si dhe fushata pastrimi në ditë të vecanta të vitit me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë qytetare në çështjet mjedisore.

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

**Për pyetjen: A ka qenë efektive performanca e aktorëve të menaxhimit të PKP lidhur me menaxhimin e ujërave të përdorura?**

**Gjetje:**

- Pjesa më e madhe e subjekteve fizike që operojnë në territorin e Parkut Kombëtar të Prespës nuk janë të lidhura me sistemin e kanalizimeve të Bashkisë Pustec dhe nuk i trajtojnë ujërat e ndotura urbane.
- Fshati Tren, nën administrimin e Bashkisë Devoll, shkarkon të gjitha ujërat e zeza në kanalën që furnizohet nga Lumi Devoll dhe që më tej komunikojnë me Liqenin e Prespës.
- Rreth 90% e shtëpive në të gjithë territorin e Parkut të Prespës kanë vendosur gropa septike për grumbullimin e ujërave të zeza, të cilat i pastrojnë dy here në vit. Të gjitha këto përfundojnë në Liqenet e Prespës duke ndikuar në cilësinë e këtyre liqeneve.
- AdZM Korçë disponon një studim lidhur me trajtimin e ujërave të ndotura për Parkun e Prespës i realizuar nga GIZ Albania.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

- Studimi për trajtimin e ujërave të zeza i realizuar nga GIZ Albania të zbatohet në fazën e dytë të projektit “Rezerva Ndërkufitare e Biosferës Prespa – Mbështetje për Parkun Kombëtar të Prespës në Shqipëri” i cili pritet të fillojë brenda vitit 2017.

***Brenda 1 viti nga nisja e projektit***

- Bashkia e Devollit të ndalojë derdhjen e ujërave të zeza të fshatit Tren në kanalën që furnizohet nga Lumi Devoll e që më pas derdhet në Prespën e Vogël.

***Brenda muajit Shkurt 2018***

- Subjektet private që operojnë në brendësi të Parkut Kombëtar të Prespës, që kanë vendosur gropa septike dhe që nuk janë të lidhura me sistemin e kanalizimeve ose nuk trajtojnë ujërat e ndotura urbane në përputhje me Ligjin nr. 9115 datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, të verifikohen nga Inspektoriati i Mjedisit dhe Inspektoriati Bashkiak e t’iu lihet afat 4-5 muaj për respektimin e këtj ligji.

***Brenda muajit Shkurt 2018***

- Nëse këto subjekte nuk marrin masa si në pikën e lartpërmendur, Inspektoriati i Mjedisit dhe Inspektoriati Bashkiak të marrin masa për kundrvajtjet administrative në përputhje me Ligjin nr. 9115 datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, neni 23 pika d, neni 24 pika 1 gërma c dhe pika 2.

***Brenda muajit Mars 2018***

- Inspektoriati i Mjedisit, dhe Inspektorati Bashkiak të ushtrojnë kontrole për respektimin e normave të shkarkimeve të lëngëta, në përputhje me Ligjin nr. 9115 datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, neni 21 pika 1.

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

Për pyetjen: **A ka qenë efektive performanca e aktorëve të menaxhimit të PKP lidhur me urbanizimin?**

**Gjetje:**

- Më datë 12.11.2014, me anë të shkresës Nr. Prot. 10896, Ministria e Mjedisit ka aplikuar për marrjen e Lejes Zhvillimore për Qendrën e Informacionit Lajthizë në Ish Komunën Pustec (sot Bashkia e Pustecit) duke i bashkëngjitur kësaj kërkesë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Ish Komuna Pustec nuk ka kthyer asnjë përgjigje dhe nuk disponon asnjë dokument që ta provojë këtë.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

- Bashkia Pustec, referuar kompetencave që i jep Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, t’i kthejë përgjigje zyrtare çdo aplikimi që bëhet pranë zyrave të saj duke dhënë një përgjigje të prerë e të argumentuar mbi bazën e ligjit të sipërcituar dhe planeve urbanistikë të miratuar lidhur me aplikimet për leje ndërtimi që bëhen në adresë të saj.

***Në vazhdimësi***

Për pyetjen: **A ka qenë efektive performanca e aktorëve të menaxhimit të PKP lidhur me ruajtjen dhe mbrojtjen e ujërave liqenorë?**

**Gjetje:**

- Edhe pse të gjithë aktorët e menaxhimit të Parkut Kombëtar të Prespës kanë pohuar se Liqeni i Prespës së Vogël nuk ka asnjë komunikim me kanalën që furnizohet nga Lumi i Devollit, grupi i auditimit ka zbuluar se komunikimi vazhdon ende. Kanali që furnizohet nga Lumi i Devollit, i cili njihet për nivelin e lartë të ujit të turbullt në afërsi të fshatit Tren, i bashkangjiten edhe të gjitha ujërat e zeza të këtij fshati me 1200 banorë. Më tej, ky kanal vazhdon rrjedhën e tij drejt Liqenit të Prespës së Vogël dhe komunikon me të nëpërmjet dy tubave me diametër afërsisht 50-70 cm të cilat ndodhen nën urë. Këto tuba, jo vetëm që bëjnë të mundur komunikimin e ujërave të Liqenit të Prespës me kanalën në fjalë, por lloje të caktuara peshqish, të cilët kanë prirje të lëvizin kundra rrymës, “migrojnë” nga Liqeni i Prespës së Vogël në drejtim të këtij kanali. Ura tjetër e ndodhur në afërsi të Shpellës së Trenit që ndodhet vetëm 100 m nga kjo urë, është dëmtuar para disa vitesh nga disa persona të cilët kanë pasur si qëllim përdorimin e ujërave të Liqenit të Prespës së Vogël për vaditje. Sot, ajo lejon totalisht komunikimin e këtij liqeni me vazhdimin e kanalit të lartpërmendur.
- Nuk ka patur asnjë plan/strategji konkrete nga ana e MBRZH AU për përmirësimin e ujërave të Parkut Kombëtar të Prespës dhe mbrojtjen e cilësisë ekologjike të tyre.



- Nuk ka asnjë studim për të vlerësuar shkallën e dëmtimit të aluvioneve në Liqenin e Prespës së Vogël, shpërndarjen e tyre gjeografike, ndikimin që kanë ato në sistemin hidrik karstik dhe në zgavrat nënujore të Liqenit të Prespës të cilat komunikojnë me Liqenin e Ohrit, si dhe shkallën e dëmtimit të potencialit hidrik të Prespës. Nuk është propozuar asnjë masë konkrete për mënjanimin e problemeve të sipërpërmendura.
- Vazhdon të ketë aktivitete ekonomike që kanë ndikuar dhe ndikojnë në ndotjen e cilësisë së ujërave të Liqeneve të Prespës si pasojë e mostrajtit të ujërave të ndotura urbane (ujërat e zeza) që ato gjenerojnë.
- Nuk është aprovuar ende Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore e parashikuar në nenin 16 të ligji nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”;
- Nuk është hartuar ende Plani i menaxhimit për basenin ujor të liqeneve të Prespës, sipas nenit 17 të ligjit Nr. 111/2012;
- Nuk ka asnjë informacion nga MBRZHUA nëse persona fizikë ose juridikë shfrytëzojnë pasuritë ujore të liqeneve të Prespës apo ushtrojnë veprimtari të ndryshme në to;
- Nuk ka asnjë inventar mbi numrin e puseve të ujit që zotërojnë banorët e Parkut të Prespës dhe asnjë financim nuk është dhënë për mbledhjen e këtyre të dhënave;
- Asnjë banor nuk është i pajisur me leje ose autorizim për shfrytëzimin e këtyre burimeve ujore;
- Inspektoriati Shtetëror i Ujit ka vendosur vetëm një masë administrative për një rast shkelje në dt. 17.11.2014, e cila kishte të bënte me hapjen e një pusshpimi pa leje nga organet përkatëse;
- Nuk ka informacione dhe nuk janë marrë masa konkrete për reduktimin e ndotjes së ujërave të Prespës;

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

- AdZM Korçë, në bashkëpunim me Bashkinë e Devollit, të marrë masa të menjëhershme për të mbyllur totalisht të dy urat e përshkuara më sipër që bëjnë të mundur komunikimin e kanalit që furnizohet nga Lumi Devoll me Liqenin e Prespës së Vogël.

***Menjëherë***

- MBRZHUA të hartojë plane konkrete për përmirësimin e cilësisë së ujërave të Prespës;

***Brenda muajit Qershor 2018***

- MBRZHUA të zotërojnë informacion të plotë dhe të detajuar në lidhje me çdo subjekt, fizik ose juridik, që mund të shfrytëzojë pasuritë ujore si dhe për ata që përdorin puse uje për nevojat e tyre, komerciale ose jo.

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

- MBRZHUA të marrë masa për të parandaluar ndërhyrjen antropogjene në Parkun e Prespës për sa i përket përdorimit të paligjshëm të burimeve ujore;

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

- MBRZHUA të ndërmarrë, së bashku me Ministrinë e Mjedisit dhe AKZM, studime për të vlerësuar shkallën e dëmtimit që kanë sjellë aluvionet në Liqenin e Prespës së Vogël, shpërndarjen e tyre gjeografike, ndikimin që kanë ato në sistemin hidrik karstik të liqenit të Prespës si dhe shkallën e dëmtimit të potencialit hidrik të Prespës;

***Brenda muajit Qershor 2018***

- Pas kryerjes së studimeve të mësipërme, MBRZHAU në bashkëpunim me AKZM dhe AdZM Korçë, të provojë në një zonë pilot pastrimin e plotë të aluvioneve të Liqenit të Prespës së Vogël dhe, nëse kjo ka rezultat, ta shtrijë në të gjithë sipërfaqen e liqenit.

***Brenda Shtator 2018***

- MBRZHAU të kërkojë pranë KM hartimin dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore.

***Brenda muajit Janar 2018***

- MBRZHAU të kërkojë pranë KM hartimin dhe miratimin e Planit të Menaxhimit për Basenin Ujor të Liqeneve të Prespës.

***Brenda muajit Janar 2018***

- Inspektoriatit Shtetëror i Ujit të ushtrijë kontroll ndaj të gjithë përdoruesve të puseve të ujit brenda territorit të Parkut Kombëtar të Prespës me qëllim pajisjen e tyre me leje shfrytëzimi për këto puse.

***Menjëherë dhe në vazhdimësi***

Për pyetjen: ***A kanë bashkëpunuar me njëra-tjetrën Ministria e Mjedisit me njësitë e qeverisjes vendore gjatë fazës së hartimit të Planit të Menaxhimit?***

**Gjetje:**

- Bashkia Pustec dhe AKZM nuk kanë patur dakordësi sa i përket çështjes së administrimit të pyjeve.
- Bashkia Pustec ka dhënë dy deklarata të ndryshme sa i përket çështjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Mjedisit dhe institucionet në varësi të saj, respektivisht në shkresat me nr. Prot. 118, datë 10.05.2017 drejtuar grupit të auditimit dhe në shkresën me nr. Prot. 22 datë 19.02.2014 drejtuar Ministrisë së Mjedisit.

Për pyetjen: ***“Si është bashkëpunimi midis Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Bujqësisë, institucioneve në varësi të tyre dhe njërive të qeverisjes vendore pas miratimit të Planit të Menaxhimit?”***

**Gjetje:**

- Nj.Q.V. (Pustec e Devoll) nuk kanë patur bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit si dhe institucionin në varësi të saj AKZM dhe AdZM Korçë në menaxhimin e PKP. Përjashtim bëjnë vetëm punimet për vendosjen e rrethimeve me shtylla betoni e rrjeta teli në vijën bregliqenore në disa fshatra të Ish Komunës Pustec.
- Bashkitë e Pustecit dhe Devollit nuk zotërojnë një kopje fizike të PMPKP.
- Versioni shqip integral nuk ekziston, por vetëm ai anglisht. Ndërkohë, versioni shqip është i paplotë dhe në shumë paragrafe citon versionin e plotë (që është i kuptueshëm vetëm nga ato persona me njohuri të thelluara të gjuhës angleze);
- ARM dhe ISHMP Korçë nuk kanë bashkëpunuar asnjëherë me bashkitë e sipërpërmendura sa i përket problemeve mjedisore dhe kontrolleve të përbashkëta në terren.
- Në të njëjtën mënyrë, Drejtoria e Politikave të Burimeve Ujore në MBRZHAU nuk ka bashkëpunuar me këto Nj.Q.V.

- PKP nuk bën pjesë në organizatën ndërkombëtare “E”, e cila është një rrjet profesional për zonat e mbrojtura europiane duke siguruar shkëmbim eksperience, bashkëpunim si dhe mbështetje me projekte teknike në menaxhimin e zonave të mbrojtura.
- Komiteti i Menaxhimit të Parkut të Prespës është mbledhur vetëm tre herë qysh nga koha e krijimit të tij, përkatësisht në datat 06.04.2012, 13.12.2013 dhe 13.02.2013.
- Përveç AdZM Korçë, stafi i institucioneve të tjera të përfshira në këtë auditim nuk kanë kryer trajnime apo aktivitete kualifikuese, të dobishme për të fituar njohuri mbi-mesatare në punën e tyre.
- Në vitin 2016 janë bërë 7 kallëzime penale, ndërsa për vitet e tjera ISHMP-ja nuk ka dhënë asnjë informacion.
- ISHMPKorçë nuk ka patur të dhëna të aksesueshme për grupin e auditimit me arsyen se zyra e ish-juristit ka qenë e mbyllur dhe pritet komisioni që do të bëjë të mundur hapjen e zyrës dhe sigurimin e të gjithë të dhënave.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

- Ministria e Mjedisit, AKZM, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural e Administrimit të Ujërave dhe institucionet e tjera në varësi të kenë bashkëpunim të plotë dhe të rregullt me Bashkitë Pustec dhe Devoll duke marrë parasysh sugjerimet e tyre.

***Në vazhdimësi***

- MM dhe AKZM të përkthejnë në gjuhën shqipe versionin integral të PMPKP dhe t’iua dërgojnë Bashkive Pustec e Devoll.

***Brenda Muajit Mars 2018***

- MM/AKZM t’i dërgojë një kopje fizike të versionit shqip të PMPKP, Bashkive Pustec e Devoll.

***Menjëherë***

- MBRZHAU dhe Drejtoria e Politikave të Burimeve Ujore, bashkë me Bashkinë Pustec e Devoll, të zhvillojnë takime midis përfaqësuesve të tyre për të shkëmbyer informacione më të detajuara në lidhje me ndotjen e burimeve ujore, ndotësit si dhe marrjen e masave për reduktim.

***Çdo 6 muaj***

- Si përfaqësues i Zonave të Mbrojtura Evropiane dhe zë kolektiv për të gjithë natyrën e peizazhet, AKZM të nisë aplikimin për anëtarësimin në rrjetin “EUROPARC” për të thelluar e bërë më shumë për mbrojtjen e PKP.

***Brenda muajit Mars 2017***

- Të mblidhet Komiteti i Menaxhimit të PKP nga Kryetari i saj për funksionimin dhe mbarëvajtjen normale të detyrave të tij.

***Menjëherë***

- MM në bashkëpunim me MBZHRAU apo edhe organizata joqeveritare mjedisore, të organizojë trajnime profesionale për punonjësit e AdZM Korçë, të ARM-së, ISHMP-së, inspektorët e peshkimit etj.

***Brenda Muajit Mars 2018 e në vazhdim***

- ISHMP Korçë të përgatisë plane vjetore/mujore për inspektimet që do kryhen në Park, si dhe të rrisë në mënyrë urgjente numrin e shpeshhtësinë e tyre.

*Brenda Muajit Mars 2018 e në vazhdim*

- MM të akordojë një fond për blerjen e mjeteve për shuarjen e zjarreve brenda Parkut.

*Me miratimin e buxhetit të vitit të ardhshëm*

Për pyetjen: ***Çfarë përfitimesh social-ekonomike ka sjellë Plani i Menaxhimit për komunitetin e Parkut?***

**Gjetje:**

- Përveç rikonstruksionit të godinës së Qendrës së Menaxhimit të Parkut në Goricë dhe ndërtimit të Qendrës së Informacionit Turistik në Pustec nuk është kryer asnjë ndërtim tjetër.
- Nga të dhënat e siguruara nga subjektet nën auditim, vetëm 3 persona të cilët jetojnë në Prespë janë të punësuar në Administratën e Parkut nga të cilët vetëm 1 është punësuar pas krijimit të AKZM-së.
- Banorët brenda parkut janë ndihmuar në disa raste për blerjen e sobave, por në asnjë rast për përdorimin e materialeve të termoizolimit në banesat e tyre, çka është edhe një nga objektivat kryesore të PMPKP sa i përket reduktimit të përdorimit të druve të zjarrit për ngrohje.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

- AKZM të propozojë në KM shtimin e numrit të punonjësve që janë rezident në territorin e Parkut të Prespës.

*Brenda vitit 2017*

- AdZM Korçë të ofrojë asistencë ndaj banorëve të parkut për përdorimin e materialeve të termoizolimit.

*Brenda muajit Mars 2018*

- AdZM Korçë, në bashkëpunim me AKZM si dhe Ministrinë e Mjedisit, të realizojë një projekt me qëllim gjenerimin e krediteve të karbonit në tregun ndërkombëtar nga ku mund të përfitohen sasi të konsiderueshme parash për shtetin shqiptar.

*Brenda vitit 2018*

Për pyetjen: ***Çfarë përfitimesh mjedisore ka sjellë Plani i Menaxhimit për komunitetin e Parkut?***

**Gjetje:**

- Bashkitë e Pustecit dhe Devollit nuk kanë bërë asnjë aktivitet me qëllim sensibilizimin e banorëve mbi rëndësinë dhe vlerat e Parkut Kombëtar të Prespës.
- AdZM Korçë ka zhvilluar disa aktivitete dhe fushata sensibilizimi me shkolla dhe shoqata të ndryshme në territorin e Parkut të Prespës.
- Subjektet që zhvillojnë veprimtari në park e që sipas ligjit duhet të pajisen me leje mjedisi të tipit “C” nuk janë të pajisura me këtë leje mjedisi.
- ISHMP Korçë nuk ka kryer kontrollet e nevojshme për pajisjen ose jo me leje mjedisi të këtyre aktiviteteve
- Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Prespës është miratuar pa Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe njëkohësisht pa Deklaratën e Ministrit të Mjedisit.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

- Bashkitë e Pustecit dhe Devollit, në bashkëpunim me AdZM Korçë, të zhvillojnë fushata ndërgjegjësimi me komunitetin e Parkut të Prespës dhe në veçanti me institucionet arsimore e kulturore.

***Në vazhdimësi***

- ISHMP Korçë të ushtrojë kontrole tek aktivitetet ekonomike brenda PKP, të cilët nuk janë të pajisur me lejet mjedisore të tipit “C”.

**Menjëherë**

- ARM Korçë të inspektojë aktivitetet ekonomike për instalimet dhe kushtet në të cilat funksionojnë, pas aplikimit të këtyre të fundit për leje mjedisi tipi C.

**Në vazhdimësi**

- Ministria e Mjedisit në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Mjedisit, (viti 2006, fq 167-168) të propozojë pranë Këshillit të Ministrave krijimin e fondit të mjedisit, ku një pjesë ose të gjitha taksat, tarifat mjedisore dhe ndëshkimet administrative të shkojnë në fondin mjedisor me qëllim përdorimin e tij vetëm për përmirësimin e cilësisë së mjedisit.

***Brenda muajit Janar 2018***

- MM të marrë masa për nisjen e realizimit të Raportit të VSM-së nga subjekte private, deri në marrjen e Deklaratës së Ministrit të Mjedisit.

**Brenda muajit Dhjetor 2017**

- MM të rishikojë dhe të propozojë ndryshime në Ligjin Nr. 91/2013 datë 28.02.2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor” për të vendosur penaltete në raste kur Plane apo Programe subjekte të këtij ligji miratohen pa Deklaratën e Ministrit dhe pa Raportin e VSM-së.

**Brenda muajit Dhjetor 2017**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim, ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**